Kronikë

Fier/ Vritet me plumb në kokë polici i 'Shqiponjave'! 28 vjeçari me uniformë po shkonte në punë! Policia 30 mijë € shpërblim për gjetjen e autorit (VIDEO + EMRI)

Një efektiv policie i forcave 'Shqiponja', vetëm 28 vjeç mbeti i vrarë sot në fshatin Baltëz të Fierit. Ka qenë ora 13:15 kur i riu polici i Forcës së Posaçme "Shqiponja" të DVP Fier, i veshur me uniformën e Policisë, po shkonte për të marrë shërbimin. Autori i dyshuar i vrasjes Azgan Mërnica është shpallur në kërkim. Shkak dyshohet konflikt i çastit

- VIDEO/ Pamjet e para nga vrasja në Fier
- Rrumbullaku: Do bëjmë gjithçka që autori të dalë para ligjit
- Pse ndodhi? Vrasja pas debatit kush të kalonte i pari
- VIDEO/ Vijojne kontrollet me dron për autorin
- VIDEOLAJM/ Vrasja e policit në Fier, efektivi vë duart në kokë, nuk i beson dot lajmit se kolegu i tij nuk jeton më
- DETAJI/ Vëllai autorit në burg për tentativë vrasjeje
- Vrasja e policit Novruz Cenalia në Fier, Balla- autorit të krimit: Dorëzohu! Policia ta kapë 'një orë e më parë'
- Babai në sallë operative, mori vesh vrasjen e të birit
- Gjendet makina me të cilën u largua autori! FNSH postblloqe në Vlorë

Redaksia
13 Maj, 13:51 | **Përditesimi: 13 Maj, 22:57**

Share

FIER- Novruz Cenalia, 28 vjeç, si çdo ditë u bë gati, veshi uniformën e Policisë së Shtetit që e mbante prej disa vitesh, pasion për policinë i trashëguar nga babai dhe u nis për punë. Rrugës, debati për radhën e kalimit me makinë me Asllan Mernicën, 23 vjeç, në fshatin Baltëz, 10 km larg Fierit, përfundoi në një tragjedi.

I riu nga fshati Sulaj, 500 metër larg në vijë ajrore me Baltëzën, nxori pistoletën që e mbante me vete dhe me një tek plumb në kokë la të vdekur në vend punonjësin e Policisë së Shtetit, i cili u shemb në tokë pa jetë. Vrasja u shënua reth orës 13:15 minuta të 13 majit 2024.

Asllan Mernica, i njohur edhe me emrin Azgan, u largua nga vendi i ngjarjes me makinën tip "Audi", ngjyrë blu, të cilën e braktisi disa kilometra me tutje dhe nga aty u arratis arave.

LEXO EDHE:
Mero Baze: 'E drejta' për të vrarë si demokrat

Në ndjekje të tij janë vënë me dhjetëra efektivë policie, përfshirë Forcat Kombëtare e Sigurisë dhe elita RENEA.

> *'I bëjmë thirrje autorit të vetë dorëzohet pasi veprimi i policisë do të jetë i ashpër. Pista kryesore është për motive të çastit. Nuk lidhje me probleme hasmërie. Makina e autorit është gjetur. Ka qenë një konflikt i çastit.'- tha Lorenc Panganika, drejtor i policisë së Fierit.*

Policia e Shtetit ofron 30 mijë euro për çdo informacion të vlefshëm që do të ndihmojë për lokalizimin dhe arrestimin e autorit, duke garantuar anonimatin e plotë. Ndërkohë, në të gjitha akset rrugore lidhëse me qarkun Fier janë ngritur pika kontrolli, ndërsa operacioni nga afër po ndiqet nga kryepolici Muhamet Rrumbullaku.

I ati i Nevruz Cenalisë është po ashtu polic pranë sallës operative të Policisë Fier, i cili dyshohet të jetë i përfshirë në një vrasje të ndodhur vite më parë në vendlindje në Has, të mbyllur në dyert e drejtësisë, çfarë fillimisht e vendosi në tavolinën e hetuesve si pistë, por u sqarua shpejt që nuk kishte lidhje. Ndërkohë, autori i ngjarjes, Asllan Mernicën, rezulton të jetë vëllai i Kiri Mërnicës, i arrestuar për tentativë vrasje.

Bashkë me 3 të tjerë më 17 prill 2021 u përfshi në një konflikt ku mbeti i plagosur Pashk Palnikaj. Po ashtu, Kiri Mërnica akuzohet si i përfshirë në një ngjarje të ndodhur në 2019-ën, ku u vra me armë zjarri Florian Selimi, me origjinë nga Tropoja dhe banues në fshatin Sulaj. I riu, Novruz Cenalia sipas burimeve nga mediat, kishte vetëm një muaj që ishte martuar, ndërsa sot ndërroi jetë.

Raportuan për Shqiptarja.com gazetarët Armand Xhelili, Kristaq Thano dhe Sokol Dema.

Shenim: Ndiqni te gjitha lajmet me poshte ne zhvillim

Polici i vrarë Novruz Cenalia

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 18:43

U vra pas sherrit se kush kalon i pari rrugën, efektivi i "Shqiponjave" në

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Fier ishte martuar vetëm para një muaji

Një detaj prekës mësohet për Novruz Cenalian, efektivin e forcave "Shqiponja", që u vra me armë në mes të ditës në fshatin Baltëz të Fierit.

I riu, sipas burimeve nga mediat, kishte vetëm një muaj që ishte martuar, ndërsa ndërroi jetë, pasi u qëllua me armë zjarri nga 23-vjeçari Azgan Mernica.

Ndërkohë policia është vënë në kërkim të autorit, ndërsa dyshohet se i riu është i armatosur.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 17:56

Fier/ Në kërkim të vrasësit të efektivit të Shqiponjave, RENEA zhvendos kërkimet pranë zonës ku banon autori

Forcat RENEA janë zhvendosur në fshatin Havaleas, disa kilometra larg fshatit Sulaj, zonë ku banon Azgan Mernica, autori i dyshuar i vrasjes së efektivit të Shqiponjave Nevruz Cenalia.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:27

Vrasja e policit Novruz Cenalia në Fier, Balla- autorit të krimit: Dorëzohu! Policia ta kapë 'një orë e më parë'

Ministri i Brendshëm Taulant Balla i ka bërë thirrje autorit të vrasjes së policit Novruz Cenalia, në Fier që të dorëzohet. Një apel pati dhe për policinë e shtetit që ta arrestojë 23 vjeçarin Asllan Mernica "një orë e më parë".

> *"Nxis policinë dhe drejtuesit e saj që të bëjnë gjithçka për arrestimin një orë e më parë të autorit. E them shpesh që do të bëjmë gjithçka që në këtë vend të ngulitet mrië në mendjen e kujtdo që është e papranueshme të ngrsh dorën ndaj një punonjësi policie. Nuk dua të hyj në interpretimin e informacioneve paraprake, ende nuk dihen arsyet. Gjithsesi përgjegjësia e parë që bie mbi policinë është identifikimi menjëhershëm i autorëve. U bëj thirrje familjarëve dhe vetë personit mbi të cilin rëndojnë akuza që të dorëzohet".*

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:46

VIDEOLAJM/ Vrasja e policit në Fier, efektivi vë duart në kokë, nuk i beson dot lajmit se kolegu i tij nuk jeton më

Një efektiv policie që duket se është kolegu i 28 vjeçarit të vrarë sot në fshatin Baltëz të Fierit nuk e fsheh dot tronditjen kur shkon në vendin e ngjarjes.

Ai ulet në gjunjë dhe nuk mund të shkojë afër vendit ku dhe ndodhet i vrarë Novruz Cenalia

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 16:35

Vrasja e efektivit në Fier, policia kontrolle me dron për autorin! Dyshohet se është fshehur në fshatin Sulaj! Gjendet edhe makina

Forca të shumta të policisë janë vënë në kërkim të Azgan Mërnicës, autori i dyshuar i vrasjes së efektivit të 'Shqiponjave', Novruz Cenaliajt, mesditën e sotme në Fier.

Policia si dhe Forcat Renea, po kryejnë kontrolle me dron dhe me qen në fshatin Sulaj, vendi ku dyshohet se është fshehur autori.

Po ashtu është sekuestruar edhe makina e autorit, i cili e ka braktisur dhe më pas është larguar,

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 15:48

Vrau efektivin e policisë në Fier, vëllai autorit në burg për tentativë vrasje (Detaje)



Kiri Mërnica

Policia ka shpallur në kërkim Azgan Mërnicën si autor të vrasjes së efektivit të 'Shqiponjave' mesditën e sotme në Fier. Policia është vënë në ndjekje të tij, ndërsa policia ka sekuestruar makinën me të cilën ai u largua.

Vëllai i Azgan Mërnicës, ***Kiri Mërnica***, aktualisht ndodhet në burg për tentativë vrasje. Ai u arrestua më 17 prill 2021 pasi bashkë me 3 të tjerë u përfshinë në një konflikt ku mbeti i plagosur Pashk Palnikaj. Kiri Mërnica në kohën kur ndodhi plagosja ndodhej në 'arrest shtëpie'.

Mërnica akuzohet si i përfshirë në një ngjarje të ndodhur në vitin 2019, ku u vra me armë zjarri 23 vjeçari Florian Selimi, me origjinë nga Tropoja dhe banues po në fshatin Sulaj. Ai u akuzua si një nga autorët e kësaj ngjarje, akuza që i mohoi.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 15:30

Vrasja e policit në Fier, burime: Shkak debati për kalimin në rrugë! 23-vjeçari e qëlloi efektivin me një plumb në kokë



Një vrasje ka tronditur mesditën e sotme (13 maj) Fierin, ku është qëlluar për vdekje efektivi i policisë Novruz Cenalia. Burime për gazetarin e Report Tv, Sokol Dema, bëjnë me dije se viktima ka qenë sot turni i 2-të dhe ka qenë duke shkuar në punën.

Me autorin Azgan Mërnica, i kanë fshatrat në vijë ajore 500 m larg. Ata të debatuar për makinën dhe shkak dyshohet një konflikt i çastit për të kaluar në rrugë, pasi rrugët në fshat janë të ngushta.

Burime bëjnë të ditur se polici është qëlluar me një plumb në kokë. Autori ka lënë makinën tek shtëpia e dajës së tij dhe është larguar nëpër ara, ndërsa policia po bën kontrolle edhe me dron.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 15:26

Vrasja e efektivit të 'Shqiponjave' në Fier, policia: Shpërblim 30 mijë euro për këdo që jep informacion për autorin Azgan Mernica



Foto: Polici i vrarë Novruz Cenalia dhe Azgan Mërnica (ne te majte)

Policia ofron 30 mijë euro shpërblim për këdo që jep informacion në lidhje me 23-vjeçarin Azgan Mërnica i cili dyshohet se është autori i vrasjes së efektivit të policisë Novruz Cenalia.

> *'Në lidhje me ngjarjen e ndodhur në fshatin Baltëz, ku u vra me armë zjarri, punonjësi i Policisë (jashtë shërbimit), shtetasi N. C., Policia e Shtetit kërkon ndihmën dhe bashkëpunimin e qytetarëve për lokalizimin e autorit të dyshuar të vrasjes, shtetasit Azgan Mernica, 23 vjeç, banues në fshatin Sulaj.*
>
> *Kushdo që ka informacion të telefonojë në numrin pa pagesë 112, duke iu garantuar anonimatin. Për çdo informacion të vlefshëm, Policia e Shtetit vë në dispozicion shpërblimin 30 000 euro.*
>
> *Ndërkohë, shërbimet e Policisë së Fierit, Forca Kombëtare e Sigurisë dhe Reparti Special "RENEA", në drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, vijojnë veprimet operacionale në zonë, me qëllim kapjen dhe vënien në pranga të 23-vjeçarit.*
>
> *Gjithashtu, në të gjitha akset rrugore lidhëse me qarkun Fier janë ngritur pika kontrolli.*
>
> *Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po vijon veprimet në vendngjarje për të sqaruar dhe dokumentuar me prova ligjore rrethanat e rastit.'- njofton policia.*

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 15:24

Vrasja policit në Fier, drejtori i Policisë: Autori të dorëzohet, ndryshe do reagojmë ashpër! Shkak, dyshohet konflikti i çastit

Lorenc Panganika, drejtor i Policisë së Fierit i ka bërë thirrje Azgan Mërnica, autori i vrasjes së efektivit Novruz Cenalisë, që të dorëzohet, pasi përndryshe reagimi i policisë do të jetë i ashpër. Drejtori i Policisë hodhi poshtë pistën e hakmarrjes dhe vrasja tha se ka ndodhur për shkak të një konflikti të çastit.

> *'Shërbente në policinë e Fierit prej 4 vitesh, prej 1 viti në FNSH*
>
> *Autori është Azgan Mërnica banues në Sulaj, po punojmë të kapim autori. I bëjmë thirrje autorit të vetë dorëzohet pasi veprimi i policisë do të jetë i aspër.*
>
> *Pista kryesore është për motive të çastit. Ska lidhje me probleme hasmërie. Makina e autorit është gjetur. Ka qenë një konflikt i çastit.'- tha Panganika.*

Xh.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:56

Vrasja e policit në Fier/ I ati efektiv vite më parë kishte vrarë një person në Has (EMRI)

(Foto: Novruz Cenali, i vrare sot ne Fier, 13 maj 2024)

Një nga pistat e hetimit është ajo e hakmarrjes, pasi shumë vite më parë dyshohet se i ati edhe ai efektiv policie ka vrarë një person.

Ngjarja ka ndodhur vite më parë në zonën e Hasit, ku dhe familja Cenalia ka jetuar më përpara. Dyshohet se babai i viktimës ka vrarë Sali Harhudhën në Has.

Burime bëjnë me dije se efektivi asokohe nuk ka pasur përgjegjësi penale. Ai punon nënoficer, roje te salla.

Sakaq vetë drejtori i policisë, Lorenc Panganika, hodhi poshtë pistën e hakmarrjes, pasi tha se ka ndodhur si pasojë e një konflikti të çastit.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:49

Ekskluzive/ FOTO e autorit dhe policit 28 vjeçar të vrarë sot në Fier



Foto: Asllan (Azgan) Mernica dhe Novruz Cenalia

Asllan (Azgan) Mernica dhe Novruz Cenalia

Report Tv siguron foton e autorit dhe të viktimës.

Ka qenë ora 13:15 kur Novruz Cenalia, polici i Forcës së Posaçme "Shqiponja" të DVP Fier, i veshur me uniformën e Policisë, po shkonte për të marrë shërbimin kur dhe ka ndodhur krimi.

Vrasja ka ndodhur pak metra pranë spitalit 'Memorial' në Fier. Burimet bëjnë me dije se autori, është identifikuar si Asllan (Azgan) Mernica i cili mendohet se u largua me një makinë

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:41

Vritet polici në Fier, sekuestrohen kamerat e sigurisë! FNSH dhe policia postbllok në hyrje të Vlorës

Ndërkohë Shqiptarja.com dhe Report Tv ka siguruar pamjet kur ekspertët po sekuestrojnë kamerat, për të verifikuar pamjet që kanë filmuar. Pamjet mund të ndihmojnë në zbardhjen e autorit, dinamikën e ngjarjes dhe itenerarin që autori ka kryer pas vrasjes së efektivit Novruz Cenalia

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:36

Vrasja e policit në Fier, gjendet makina me të cilën është larguar autori! FNSH postbllogë në Vlorë

Foto: Polici i FNSH postobllok në Vlorë, 13 maj

Policia ka arritur që të gjejë makinën me të cilën është larguar autori i vrasjes së policit 28-vjeçar Novruz Cenalia, bëjnë me dije burime për Report Tv.

Makina është gjetur e braktisur në një lagje afër fshatit Baltëz në Fier, pra afër vendit të vrasjes.

Ndërkohë, FNSH ka ngritur postbllogë në Vlorë me qëllim kapjen e autorit, i identifikuar si Asllan (Azgan) Mernica. Report Tv sjell edhe pamjet nga postbllogët e FNSH.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 14:26

Vritet efektivi në Fier, babai i tij, Asllan Cenalia është polic, ishte në detyrë te salla operative

Foto: Kufoma e Novruz Cenalia

Dy pista hetimi kryesore janë momentalisht pas vrasjes së policit 28 vjeçar.

E para ka të bëjë me një pistë hakmarrjeje. I ati i viktimës punon si polic në sallën operative në komisariatin e Fierit. Mësohet se disa vite më parë mendohet se ka kryer një vrasje dhe dyshohet se kjo ka lidhje me vrasjen.

Nuk përjashtohet as pista e vrasjes pas një sherri momental.

Familja Cenalia është nga Hasi i Kukësit dhe jetonte në Fier.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:14

Vritet polici në Fier, RENEA po kreh zonën, dyshohet se autori është afër, ja pista e parë e hetimit

Forcat RENEA kanë rrethuar zonën pasi dyshohet se autori vetëm 23 vjeçar nuk ka mundur të largohet më tej. Autori është identifikuar si Asllan (Azgan) Mernica. Dyshohet se vrasja ka si pistë hetimi një krim që babai i policit 28 vjeçar ka kryer vite më parë dhe dyshohet se kemi të bëjmë me një hakmarrje.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:13

Vrasja e policit, RENEA zbarkon në Fier! Blindon zonën

RENEA ka mbërritur në Fier pas vrasjes së policit Novruz Cenalia.

Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes në fshatin Baltëz, ku RENA ka 'blinduar' zonën.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 14:01

Identifikohet polici i vrarë në Fier, po shkonte për të marrë shërbimin



Policia informon se ngjarja është shënuar rreth orës 13:15 minuta

> *Rreth orës 13:15, në fshatin Baltëz, dyshohet se gjatë një konflikti të çastit, shtetasi A. M. ka vrarë me armë zjarri shtetasin Novruz Cenalia, punonjës policie i Forcës së Posaçme "Shqiponja" të DVP Fier, jashtë shërbimi, por i veshur me uniformën e Policisë, pasi shkonte për të marrë shërbimin.*
>
> *Menjëherë në vendngjarje janë nisur shërbimet e Policisë, Forca Kombëtare e Sigurisë, Reparti Special "RENEA", të cilat kanë rrethuar zonën dhe vijojnë punën për kapjen e autorit.*
>
> *Grupi hetimor dhe drejtues të Departamentit të Policisë Kriminale, në drejtimin e Prokurorisë, po punojnë për sqarimin e rrethanave dhe për dokumentimin ligjor të kësaj ngjarjeje.*

S.G/Shqiptarja.com

Share

S.G/M.Q./Shqiptarja.com

TAG: asllan mernica | Novruz Cenalia | vrasja e policit ne fier | Fier

Komento

Komente

elia: 14/05/2024 10:10

tragjedi eshte per dy te rinj.po policia me doemos duhet te hapi rruge nje te riu duke treguar qytetari jo te bejn si te forte.

Përgjigju

Iris: 14/05/2024 02:51

Dhe e gjithe tragjedia per nje /kush kalon i pari/! Njerez,nuk jeni ne rregull nga trute!

Përgjigju

Matrix: 13/05/2024 23:34

Vrasesi i lindur ne has dhe me banim ne fier,i ati viktimes ka vrare 1 person ne has. Dhe 1 femij 5 vjec e kupton qe nuk esht vrasje per nje parakalim makinash

Përgjigju

Vipi: 13/05/2024 23:12

Fatin e këtij do ketë edhe ndonjë nga ata fshatarët e Shqiponjave të Vlorës spiunat e mutit.

Përgjigju

Fshati sulaj: 13/05/2024 19:17

Ky mernica eshte dial i mire,por qe kur e perdhunuan zezaket ne burgun e frances per nje muaj rresht ka pasur probleme me trut e kokes..eh ja ben sumen si kazan rakie te shkretit e vinte turp nga fshati per zezaket qe e perdhunuan eger per nje muaj diten dhe naten deng deng...

Përgjigju

Krietari Fshatit: 14/05/2024 11:34

Po Ty kush ta tha re, Motra, mami, apo Ajo motra vogel qe e ka xhan kte Mernicen. Ja shko verifikoje nje heree ere

Roni: 13/05/2024 19:03

Pa gjykyar rrethanat e ngjarjes kaq vlen informacioni per jeten e mare te policit te shtetit? Vetem 30 mije euro??

Përgjigju

Vipi: 14/05/2024 12:23

@Roni po janë paratë tona si popull ato që ky shtet i degjeneruar po na i grabit me taksa dhe me fatura apo do i pagojnë motrat e tua se kanë para punojnë rrugëve të q..... rracën.

Olti: 13/05/2024 18:15

I lutem zotit qe vajza ime 10 vjeçare dhe djali il 1 vjeçare. Të rriten larg nga ky brez i dhjetë. Si policët gango, si nga gangot që gjezdisin me pistoletë me vete si kur me e pas shishe uji. I lutem zotit qe te rriten ma njërëzore...

Përgjigju

AltinTop: 13/05/2024 17:45

Perderisa quhet "Konflikt i castit" te dyja palet kane te njejtn nivel...fati i keq qe perfunduan ne ekstrem. Keto sjane te zotet te sigurojne jeten e vet.. e jo me te qytetareve..

Përgjigju

Emigrant: 13/05/2024 17:42

Keta qe vrasin policat te mos qellohet ne ajer por drejt e ne mish Ngushellime familjes se policit Ngushellime dhe forcave policore

Përgjigju

fredi: 13/05/2024 16:41

Keshtu eshte kur eshte hequr ligji me varje.

Përgjigju

SKAP: 13/05/2024 19:24

Ske faj, . ju ka kap sindroma stokolmit. 70% e Policis jane Bandita o Pall.

Koha: 13/05/2024 16:23

Ishte ceshtje kohe qe nje ngjarje e tille te ndodhte. Reparti Shqiponja eshte i mbushur me arrogante, gangestere, trafikant dhe perdorues te droges. Nese mendohet se do luftohet krimi me te tille njerez, atehere viktimat nga ky repart do te shtohen. Krimi luftohet me ligjshmeri dhe jo me horra te veshur me uniforme.

Përgjigju

Qitetari: 14/05/2024 11:30

Jo 100% por 111% se harrove te shtosh kryesoret, Ministri dhe Shefat e tyre qe dalin vazhdimisht ne pergjime pir si nxjerrin akoma se falimenton Policia, kshuqe po presin te marrin te rinj qe jane edukuar nga jy sistem e dardha bie nen dardh e mos me keq ky shtet. Mos me Keq. Une them te ikim

Turi: 13/05/2024 17:21

Me keqardhje te madhe te mbeshtese,ke te drejt 100%

Popull: 13/05/2024 16:19

Nese policet me xhama te zinj e qe sillen si gangster ju japin bezdi,mjafton ti denonconi ne media ose ne komisariatin digital.Nese keni frik ta beni ateher mir ju behet qe sillen ashtu me juve.Sado gangster te jet polici nuk i merret jeta tjetrit.Uniforma esht shteti,e dim gjith qenky shtet esht kalbur nga koka por faji esht dhe i yni

Përgjigju

Halit: 13/05/2024 16:15

Nje patronazhist me pak

Përgjigju

Populli: 13/05/2024 16:12

Kush vret duhet vrare. E vrau nga halli, e vrau per qejf, e vrau se i zuri rruegen etj etj, vrasesi duhet vrare. Pastaj kush vret punonjes policie, oficer, Prokuor Gjykates etj duhet ekzerkutuar nga RENEA ne momentin qe lokalizohet edhe eleminohet

Përgjigju

Populist: 13/05/2024 17:25

Dakort me ty, por prokuror dhe gjykates te koruptuar nuk i vret njeri se jane pale me krimin. Po ai plehra qe vrau Klodian Rashen a duhej vrare? Po shoket e tij qe hodhen pistoleten sikur ishte e viktimes duhen vrare? Shqiponjat sillen si horra me njerezit dhe jo si police te shtetit.

Ben ahmetaj: 13/05/2024 16:11

Po pra po policet qe kujtojn se uniforma i ben te fort apo varja e i bin ne qaf robve e zen rrug e bejn si pronar tokash. Kush e kerkon e gjen

Përgjigju

Parajsë për taksa: 13/05/2024 15:54

30 mijë euro paska lek shteti or tej

Përgjigju

Or tej: 13/05/2024 19:40

Me leket tona e paguan or teeeejjjjj

Ku jetojm: 13/05/2024 15:40

Babai paska vrar nje njeri e punoka polic , edhe ky me bab vrases polic ! Kushedi si ka ber si i fort ky me kapele me arme te shtetit ne brez e me baba vrases

Përgjigju

Dori: 13/05/2024 14:43

Kush vret polic duhet te eliminohet nga RENEA dhe jo te arrestohet.Te behet shembull qe po preke policin ke prek shtetin

Përgjigju

Alb: 13/05/2024 22:56

Gjysma e ketyre te shqiponjave i ke spat ne mall shesin e pijn pjesa tjeter i kan marr me precedent penal per vjedhje edhe ata qe sjan polica si ka pjell lopa kan seder.

Experti: 13/05/2024 16:44

O dori pomir mor daj po ku policat rrin me makina xhaka te zij parakalojn site fort . Dhe ky ruhesh nga puna e vellaj plus kur ka deghuar theks malsori ka kujtu se osht ne prit prej te vellaj dhe ka gabimin fatal . Ka thon let qaj nona ketij para nones teme. Ngushellime familje gjynah se djal i ri.

Vipi: 13/05/2024 16:40

Mirë ja u bëjnë policave plehrave që i vrasin se sillen keq me njerëzit.

geni: 13/05/2024 16:11

po persersi fjalet e dorit kush vret polic te eleminohet kush gre dore mbi forcat e rendit te eleminohet

Arben: 13/05/2024 15:56

Jo. Por per cdo vrasje polici ne Shqiperi ti shtohet Saliut nje vit burg! Se vetem prej kaosit qe krijoi Saliu dikur, sot po vuajme pasojat! Njerezit jane mesuar te mos kene pergjegjesi per asgje! E vrasin tjetrin krejt kot! Saliu e futi kete mentalitet!

O dori: 13/05/2024 15:16

Po per keto policet me makina me targa te huaja e xhama te zi e kapele qe bejn si te fort si cuba , ca duhet te ju bejm ?

Ehhh: 13/05/2024 14:17

Polic me makina me xhama te zij me targa te huaja bejn si te fort arrogante nuk kuptohet a jan polic a jan gango . Normal qe edhe ndonje do vritet

Përgjigju

gasper: 13/05/2024 14:12

U bene dhe lalucet si maloket...

Përgjigju

kiraskiras: 13/05/2024 18:04

Hahahaha....nga mbiemri janë tropojanë....

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:

Si i vlerësoni mesazhet që dha Rama në takimin me diasporën në Athinë?

Të duhura | Të gabuara | Nuk e di

Lajme të tjera

Luan Baçi: S'jam pishman për foton me vrasësin e policit në Fier! Mërnica familje demokrate e nderuar! S'ka qenë te protestat para bashkisë Tiranë

14 Maj, 17:42

Komisioni i Sigurisë mban 1 minutë heshtje për policin e vrarë në Fier! Salianji: Autori të marrë ndëshkimin e merituar

14 Maj, 15:01

Vrasja e policit pas sherrit kush do kalojë rrugën, sociologu: Shoqëri e dhunshme, se perceptojmë dot që ligji duhet zbatuar

14 Maj, 14:39

E shkuara kriminale e familjes së vrasësit të policit në Fier! Babai u dënua me 20 vite për vrasjen e kunatit, 2 vëllezërit e tij ende në burg

14 Maj, 14:23

Vrasja e efektivit të 'Shqiponjave' në Fier/ ish-drejtori, Gledis Nano: Të rritet ndërgjegjësimi për sfidat me të cilat përballen forcat policore

14 Maj, 13:58

Në takimin e Ramës në Athinë, jep dorëheqjen drejtori i teatrit 'Bylis'! Marku: Në Greqi isha për festivalin teatror! Tubimi, rastësi

14 Maj, 12:06

Vrasësi i policit në Fier krah deputetit të Berishës! Pjesë e Strukturës së Armatosur të PD për Mbrojtjen e Votës në 2021 (FOTO)

14 Maj, 10:39

Vrasja e policit në Fier, autori ende në arrati! Kontrollet shtrihen edhe në Gjirokastër e Tepelenë! E shkuara kriminale e familjes Mërnica, babai u dënua me 20 vite, 2 vëllezër në burg

14 Maj, 08:15

U vra pas sherrit se kush kalon i pari rrugën, efektivi i "Shqiponjave" në Fier ishte martuar vetëm para një muaji

13 Maj, 18:43

Fermerët në protestë, bllokojnë rrugën Berat-Lushnje, derdhin domatet e kastravecët në rrugë: Stop abuzimit me çmimet!

Mimoza Sinanaj

13 Maj, 16:00

Rrebesh shiu dhe breshër në Fier, dëmtohen të mbjellat e fermerëve: Na u shkatërrua i gjithë mundi në 30 minuta (Video)

Kristaq Thano

11 Maj, 16:17

Fier/ Zbulohen 3 lokale ku ushtroheshin lojërat e fatit, 3 persona në hetim, vijon puna për kapjen e një tjetri

11 Maj, 16:02

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje